



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
MINISTRI

Nr. 3678 Prot

Tiranë, më 05.06.2017

URDHËR

Nr. 334 datë 05.06.2017

PËR

**“ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 473, DATË 01.06.2017 PËR “MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES APO PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, GJATË PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË 2017”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. nr.473, datë 01.06.2017 për “Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në kuvendin e shqipërisë për vitin 2017”,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017, duke ndjekur dhe zbatuar aktet ligjore e nënligjore, punonjësit e Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi, kanë të drejtat dhe detyrimet, si më poshtë:
  - a) punonjësve të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, u krijohen kushtet e nevojshme dhe u garantohet mosçenimi i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislationit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor;
  - b) punonjësit e Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucionit, kanë të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje;
  - c) punonjësi i Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucionit, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushate zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje;

- d) punonjësi i Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprotin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale që punjoësi kryen.
  - e) Nëpunësit civil të Ministrisë së Kulturës ose institucioneve në varësi të saj, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, në kuptim të nenit 37, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, i ndalohej:
    - i) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor;
    - ii) të manifestojë me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;
    - iii) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike.
  - f) Punonjësit e Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj, i ndalohej të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe drejtuesit e institucioneve në varësi, të marrin masat e nevojshme për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të strukturave përkatëse, të cilët duhet të kenë për detyrë:
- a) kontrollimin në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve nën varësinë e tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje;
  - b) verifikimin dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.
  - c) të monitorojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM-ja nr.473, datë 01.06.2017, për të garantuar mospërdorimin e:
    - i) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike";
    - ii) fondeve të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;
    - iii) mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;
    - iv) zhvillimit të fushatës zgjedhore në Ministrinë e Kulturës apo realizimit të propagandës politike në ministri;



- v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;
  - vi) detyruar, në fushatë zgjedhore, të administratës së institucionit brenda ose jashtë orarit të punës.
- d) Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit, ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara në zgjedhje.
3. Me qëllim shmangjen e keqpërdorimit të aktiviteteve institucionale me fuashtën elektorale, ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe drejtuesit e institucioneve në varësi, që të publikojnë në faqen zyrtare:
- a) Të dhëna për aktivitet publike, të programuar për muajt qershor dhe korrik;
  - b) Listën e projekteve të nisura prej 12 muajsh, në ushtrim të funksionit të veprimtarisë së tyre.
4. T'u krijohet mundësia vëzhguesve ose shoqatave të interesuara të regjistruara në KQZ, për akses për marrjen e informacionit në lidhje me detyrimet e administratës publike për procesin zgjedhor.
5. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në zbatim të pikës 14 të VKM nr.473, datë 01.06.2017, të marrë masat menjëherë për të publikuar në adresën e e-mail në faqen zyrtare të internetit, duke bërë njoftimin për denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen të gjitha strukturat e Ministrisë së Kulturës dhe institucionet në varësi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Mirela KUMBARO FURXHI**

**NË MUNGESË DHE ME FUQI  
ZV. MINISTRI**

